

SHOQËRISË ME PËRÇJEGJËSI TË KUFIZUAR

"KREYZA & DM"

Në këtë akt themelimi, i cili ka vlerën e ligjit, unë orteku i vetëm David Ulqineku, banues në Tiranë, i kombësisë shqiptare, bie dakort dhe nënshkruaj sa më poshtë:

1. Është krijuar nga ana ime një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar me emrin "KREYZA & DM"

2. Shoqëria ka qendrën, selinë e saj në Rr. Siri Kodre, Nr. 59/1 Tiranë.

3. Shoqëria ka objektin e mëposhtëm, të përcaktuar më mirë në statutin e saj tregtimin me shumicë e pakicë i mallrave të ndryshme industriale dhe ushqimore, lëndë të para e materiale ndertimi, pajisje elektro shtëpiake, prodhime kosmetike, farmaceutike, bimë medicinale eterovajore, duhane e cigare, konfeksione e tekstile të çdo lloji, fruta e perime, kultivim e tregtim lule, vetura e mjete transporti të çdo tipi e marke, pjesë këmbimi për mjete motorike, shërbim transporti, ekspedicioni mallrash dhe udhëtuesh, import eksport brëndë dhe jashtë vëndit, shërbim hotelerie e shtriami, kreditime legale, kambizëm dhe çdo lloj operacioni financiar, investime të ndryshme ose kapitale në fusha të ndryshme, tregti karburanti dhe të nënprodukteve të naftës, hapje agjensi të ndryshme detare, ajrore, etj.

4. Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar nga themelimi i saj deri mbi 10 vjet.

5. Kapitulli i shoqërisë është 100.000 lekë.

6. Funkcionimi i shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në organet e financave të shtetit.

7. Ushtrimi i parë mbyllet në fund të çdo viti kalendarik.

8. Shoqëria besohet në dispozitet ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë si dhe në aktin dhe statutin Bashkëngjitur.

THEMELUESI I SHOQËRISË

David Ulqineku



S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "KRYEZA & DM"

Perkufizimi dhe emertimi

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Kryeza & DM" themelohet nga z. David Ulqinaku i cila me poshte do te quhet "ortaku i vetem"

Neni 2

Emertimi i shoqerise do te jete "KRYEZA & DM" Sh.p.k.

Neni 3

Selia e shoqerise eshte ne Tirane , Rr. Siri Kodra, Nr. 59/1, Tiranë

Forma e shoqerise

Neni 4

Shoqeria "K R Y E Z A & D M" sh.p.k. organizohet ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit ne fuqi. Ortaku i vetem gjate aktivitetit te tij do te perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise si dhe ne nje vlere qe mund te konsideroje veteortaku i vetem.

Kohezgjatja

Neni 5

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise shtrihet ne mbi 10 (dhjete) vjet. Fillimi i aktivitetit legal do te konsiderohet data e regjistrimit ne organet e financave te shtetit.

Objekti

Neni 6

Objekti i shoqerise:

Tregtimi me shumice e pakice i mallrave te ndryshme industriale dhe ushqimore, lende te para e materiale ndertimi, paisje elektro shtepiake, prodhime kozmetike, farmaceutike, bime medicinale, eterovajore duhane e cigare, konfeksione e tekstile te cdo lloi, fruta e perime kultivim e tregtim lule, vetura e mjete transporti te cdo tipi e marke , pjese kembimi per mjete motorike.

Sherbim transporti, spedicioni, mallrash dhe udhetaresh..

Import export brenda dhe jashte vendit.


Sherbim hotelerie e turizmi

Kreditime legale, kambizim dhe cdo lloj operacioni financiar.

Investime te ndryshme ose kapitale ne fusha te ndryshme

Tregti karburanti dhe te nenproduktet e naftes.

Hapje agjensi te ndryshme detare, ajrore, etj



Kapitali themeltarNeni 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000(njeqindmije) lek. Kapitali i saj mund te shtohet ose pakesohet me vendim te ortakut te vetem. Transferime te pjeseve te kapitalit themeltar duhet te v-vertetohen me nje akt noterial.

Personaliteti juridikNeni 8

Shoqeria fiton te drejten e personit juridik me regjistrimin e saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane, ndersa aktivitetin ekonomik e fillon me regjistrimin e saj ne organet e financave te shtetit.

AdministrimiNeni 9

Shoqeria administrohet nga ortaku i vetem qe eshte David Ulqinaku .Shoqeria mund te administrohet dhe nga nje administrator i cili emerohet me vendim te ortakut te vetem. Mandati i administrimit te tyre percaktohet me kontrate pune. Ne kontraten e punes percaktohen shprehimisht te drejtat dhe detyrat e administratorit te emeruar.

Raporti i administrimit, inventarit dhe llogarite vjetore hartoen nga ortaku i vetem. Ndersa kur ka administrator te emeruar ato hartohen prej ketij te fundit. Ne kete rast ortaku i vetem miraton llogarite, inventarin dhe raportin e administrimit brenda nje afati prej 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar..

Ortaku i vetem mund ti delegoje kopetencat e tij me shkrim ne forme te autorizimit ose me prokure legale..

Vendimi i ortakut te vetem eidentohet ne nje regjister te vecante.

Neni 10

Ortaku i vetem ose administratori i tij jane te veshur sipas percaktimit te nenit 9 te ketij statuti me te gjitha fuqite legale per organizimin e drejtimin e shoqerise. Ata kane te drejta te kryejn te gjitha veprimet qe i konsiderojne te nevojshme brenda ligjit per realizimin e qellimeve te shoqerise..

Ortaku i vetem drejton dhe administron shoqerine ne baze te ketij statuti dhe legjislacionit ne fuqi.

Perfaqesimi :Neni 11

Perfaqesimi i shoqerise realizohet nga ortaku i vetem ose nga te autorizuarit prej tij me prokure legale.

FinancaNeni 12

Veprimtaria ekonomiko financiare e shoqerise mbyllet ne fund te vitit kalendarik. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore, ortakut i vetem ose administratori ose ekspertit kontabel i emeruar perpilon bilancin kontabel te shoqerise me rezultatin humbje fitime, bilanc i cili miratohet nga ortakut i vetem.

Emertimi i ekspertit kontabelNeni 13

Emertimi i ekspertit kontabel behet me vendim te ortakut te vetem. Shoqeria eshte e detyruar te caktojte nje ekspert kontabel ne keto raste, kur ne mbyllje te vitit financiar tejkalohen dy shifra te meposhtme:

- Bilanci ne mbyllje te vitit 12 miljo leke.
- Vlefta e te ardhurave nga qarkullimi ne mbyllje te viti, pasi eshte zbritur tatimi mbi qarkullimin 24 milion leke
- Mesatarisht 50 te punesuar gjate vitit financiar.

Mardheniet e punesNeni 14

Mardheniet juridike te punes rregullohen me ane te kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen me kontrate pune, zbatohen dispozitat e punes ne fuqi.

PagatNeni 15

Pagat dhe shperblimet e punes per te punesuarit e shoqerise do te caktohen me kontrate pune dhe konforme normave legale ne fuqi. Detyrimet ndaj siguracioneve do te derdhen prane sigurimeve shoqerore dhe shteterore sipas kontributit perkates konforme ligjes.

Mosmareveshjet ne puneNeni '16

Mosmareveshjet ne pune zgjidhen me pajtim midis punedhenesit dhe te punesuarit. Ne te kundert duhen respektuar kushtet e percaktuara ne kontraten e punes midis tyre.

Ne rruge gjyqesore organi kopetent per zgjidhjen e mosmarreveshjeve do te jete gjykata e Rrethit Tirane.

Ndryshimet e statutitNeni 17

Ndryshimet e statutit mund te behen me vendim te ortakut te vetem sipas dispozitave ligjore.

Shnderimi i shoqeriseNeni 20

Shperndarja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per

shkqaje te parashikuara ne ligj. Shperndarja mund te behet (realizohet) edhe me vendim te ortakut te vetem.

Dispozita perfundimtare

Neni 21

Statu hyn ne fuqi ditën e nënshkrimit te tij nga ortakut i vetem

"ORTAKU I VETEM"
David Ulqinaku

Tirane, me _____



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

NOTERIA

Mr. Ulqinaku Rep.

Mr. Ulqinaku Sol.

V E N D O R T I M

Bot me dt.19.1.1995 , u paraqit personalisht David Ulqinaku , madhor ne otesit te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u binda nga leternjoftimi i tij perosnel i cili me deklaroi se sa me siper eshte redaktuar jashte kesaj Zyre sipas vullnetit te tij te lire dhe te plote , nënshkruan rregullisht para meje dhe une noterja e vertetohet sipas ligjit.



NOTE RE
IRENA LAHA
TIRANE-ALBANIA

